



Prishtinë, 30 Qershor 2009
Kodi i ZRRE-së: V_194_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 14 të Licencës Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
3. Kërkesë zyrtare të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të KEK Sh.a. të dërguar me date 23.04.2009, **në seancën e mbajtur me date 30 qershor 2009, nxorri këtë:**

VENDIM

- I. **Aprovohet** Kodi i Punës për Qasje ne Tokë dhe Ndërtesa i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së KEK Sh.a.

Arsyetim

1. Bazuar në obligimet që dalin nga Licenca e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) Sh.a, në Prill të vitit 2009 OSSH/KEK sh.a ka ushtruar kërkesën për miratimin e Kodi të Punës për Qasje ne Toka dhe Ndërtesa.
2. ZRRE ka shqyrtuar Kodin në fjalë, dhe pas vlerësimit dhe plotësimit të të njëjtit ka aprovuar atë.
3. Gjatë analizimit të Kodit, ZRRE ka vlerësuar se i njëjti përmban dispozita ku përcaktohen parimet dhe procedurat që KEK-u do të ndjekë për qasje në tokë dhe ndërtesë të cilat janë në pronësi ose kontroll të palëve tjera, gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta.
3. **Obligohet** i licencuari që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë ta publikojë këtë Kod në faqen e tij zyrtare elektronike.
4. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve , do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Vendimi hyn në fuqi datën e nxjerrjes të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkangjitur: Versioni i miratuar i Kodit të Punës për Qasje ne Tokë dhe Ndërtesa për OSSH/KEK Sh.a .

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar